

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08- 698/1 dt. 29.07.2013**  
**PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR SJELLJEN E PLANIT TË**  
**VEPRIMIT LOKAL PËR BIODIVERSITETIN (PVLB) PËR**  
**KOMUNËN DIBËR**

**53.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),  
Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET vendimi për sjelljen e Planin për Veprim Lokal për Biodiversitetin për Komunën Dibër PVLB, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e pestë dt.25.07.2013.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**V E N D I M**

**Nr.07-675/3 dt.25.07.2013**

**PËR SJELLJEN E PLANIT TË VEPRIMIT LOKAL PËR  
BIODIVERSITETIN (PVLB) PËR KOMUNËN DIBËR**

**54.**Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e natyrës (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 67/2004, 14/2006, 84/2007, 35/2010, 47/2011, 148/2011, 59/2012 dhe 13/2013), nenit 36 të Ligjit për veteqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 5/2002) si dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e komunës Dibër”nr. 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 5<sup>te</sup> dt.25.07.2013 vendosi:

**Neni 1**

Këshilli i Komunës Dibër sjell PVLB - Planin e Veprimit Lokal për Biodiversitetin për Komunën Dibër, propozuar nga grupi i punës dhe Kryetari i Komunës Dibër.

**Neni 2**

Me këtë plan rregullohet mbrojtja e natyrës nëpërmjet mbrojtjes së larmisë biologjike dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore si dhe shrytëzim të qëndrueshëm të tyre në interes të zhvillimit ekonomik. Ky plan është përgatitur me përkrahje financiare nga Qeveria e Finlandës, nëpërmjet ECNC ( Qendra Evropjane për mbrojtjen e natyrës), në bashkëpunim me Qendrën Rajonale për mjedisin jetësor (QRMJ-REC) -Zyra në Maqedoni.

**Neni 3**

Plani i Veprimit Lokal për Biodiversitetin për Komunën Dibër- PVLB, është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në Kumtesën zyrtare të komunës Dibër.

**KËSHILLI I KOMUNËS  
Kryetari,  
Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**

**Nr.08- 698/2 dt. 29.07.2013**

**PËR SHPALLJE PËR VENDIMIT PËRCAKTIMIN E KOMPENSIMIT TË  
SHPENZIMEVE ZGJEDHORE ORGANIZATORËVE TË FUSHATËS  
ZGJEDHORE KANDIDATËT E TË CILËVE JANË ZGJEDHUR  
ANËTARË TË KËSHILLIT TË KOMUNËS DHE KRYETAR I KOMUNËS  
DIBËR NË ZGJEDHJET LOKALE 2013**

55.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET vendimi për përcaktimin e kompensimit për shpenzimet zgjedhore organizatorëve të fushatës zgjedhore në zgjedhjet lokale 2013, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e pestë dt.25.07.2013.

**KOMUNA DIBËR**

**Kryetari,**

**Ruzhdi Lata d.v.**

**V E N D I M**

**Nr. 07-675/4 dt.25.07.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE  
ZGJEDHORE ORGANIZATORËVE TË FUSHATËS ZGJEDHORE  
KANDIDATËT E TË CILËVE JANË ZGJEDHUR ANËTARË TË  
KËSHILLIT TË KOMUNËS DHE KRYETAR I KOMUNËS DIBËR NË  
ZGJEDHJET LOKALE 2013**

**Neni 1**

**56.**Me këtë vendim përcaktohet kompensimi për shpenzimet zgjedhore organizatorëve të fushatës zgjedhore kandidatët e të cilëve janë zgjedhur anëtarë të Këshillit të Komunës dhe Kryetar të Komunës Dibër në zgjedhjet lokale 2013.

**Neni 2**

Organizatorëve të fushatës zgjedhore kandidatët e të cilëve janë zgjedhur anëtarë të Këshillit të Komunës dhe Kryetar i Komunës Dibër në zgjedhjet lokale 2013 në përputhje më Raportet për shpenzimet lidhur me fushatën zgjedhore dhe Raportin e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve për rezultatet përfundimtare zgjedhore u përcaktohet kompensim në lartësinë prej 15 denarë për votë të fituar, dhe ate:

-BDI-Bashkim Demokratik për Integrim për kandidat për Kryetar të Komunë për marrjen e 6056 votave -Mjetet të paguhen në llogarinë 280101102462776 deponuar te _____	90.840,00 denarë
-BDI-Bashkim Demokratik për Integrim për listën e kandidatëve për anëtar të Këshillit për marrjen e 3839 votave -Mjetet të paguhen në llogarinë 280101102462776 deponuar te _____	57.585,00 denarë
-VMRO-DPMNE koalicioni për zgjedhje për listën e kandidatëve për anëtar të Këshillit për marrjen e 1027 votave -Mjetet të paguhen në llogarinë 210 068503830114 deponuar te Tutunska Banka.	15.405,00 denarë
-PDSH-Partia Demokratike Shqiptare për listën e kandidatëve për anëtar të Këshillit për marrjen e 1163 votave -Mjetet të paguhen në llogarinë 290-0000015180-04 deponuar te TTK Banka.	17.445,00 denarë
-LSDM dhe tjerë për listën e kandidatëve për anëtar të Këshilli për marrjen e 716 votave Mjetet të paguhen në llogarinë 300000003564883 deponuar te Banka Komerciale.	10.740,00 denarë
-Grupi i zgjedhësve Jaku Marku për listën e kandidatëve për anëtar të Këshilli për marrjen e 611 votave -Mjetet të paguhen në llogarinë 300000003564883 deponuar te Banka Komerciale	9165,00 denarë

**Neni 3**

Kompensimi për shpenzimet zgjedhore përcaktuar në nenin 2 të Vendimit do të paguhet nga mjetet e Buxhetit të Komunës Dibër për vitin 2013.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Kumtesën zyrtare të Komunës.

**KËSHILLI I KOMUNËS**

**Kryetari,  
Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**

**Nr.08- 698/3 dt. 29.07.2013**

**PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E RELACIONEVE  
DHE VENDEVE TË TRANSPORTIT ME FURGONË ME MINIMUM  
NËNTË KARIKE (8+1) NË TRANSPORT TË UDHËTARËVE NË LINJË  
KOMUNALE NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR**

**57.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET vendimi për përcaktimin e relacioneve dhe vendeve të transportit me furgonë me minimum nëntë karike (8+1) në transport të udhëtarëve në linjë komunale në territorin e Komunës Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e pestë dt.25.07.2013.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**V E N D I M**

**Nr.07-675/5 dt.25.07.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E RELACIONEVE DHE VENDEVE TË  
TRANSPORTIT ME FURGONË ME MINIMUM NËNTË KARIKE (8+1)  
NË TRANSPORT TË UDHËTARËVE NË LINJË KOMUNALE NË  
TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR**

**58.**Në mbështetje të nenit 22 paragrafi 1 alineja 7 të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor („Gazeta zyrtare e RM”, 68/2004, 127/2006, 114/2009, 83/10, 140/10, 17/11, 53/11, 6/12 dhe 23/13), nenit 39 të Vendimit për transport komunal të udhëtarëve në teritorin e Komunës Dibër nr. 07-453/6 dt. 29.05.2013 (“Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër” nr.3/13) si dhe nenit 27, paragrafi 1, pika 20 të Statutit të Komunës Dibër ( Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër” nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër, në seancën 5<sup>të</sup> dt. 25.07.2013 vendosi:

**Neni 1**

Me këtë Vendim rregullohet relacionet dhe vendet të transportit me furgonë me minimum nëntë karrike (8+1) në transport të udhëtarëve në linjë komunale në teritorin e Komunës Dibër.

**Neni 2**

Linja në transportin komunal në linjë të udhëtarëve në teritorin e Komunës Dibër është relacion i përcaktuar dhe drejtim i vozitjes nga stacioni fillestar deri te mbarimi ose vendndalesës në të cilën transportohen udhëtarët në transportin komunal, në pajtim me paraprakisht të përcaktuar, rendin e rregjistruar dhe të shpallur dhe çmimit të transportit.

Relacion i transportit të udhëtarëve në linja komunale në teritorin e komunës Dibër është largësia mes çfardo dy vendeve në teritorin e komunës Dibër në linjat e përcaktuara në transportin komunal të udhëtarëve, të evidentuara në orarin e udhëtimit si stacion ose ndalesë.

**Neni 3**

Në transportin të udhëtarëve në linja komunale në teritorin e Komunës Dibër si relacione për transport me furgonë me minimum nëntë karrike (8+1) përcaktohen relacionet në vijim:

- |                                 |                                 |
|---------------------------------|---------------------------------|
| 1. Dibër - f. Kosovrast i Epërm | 2. f. Kosovrast i Epërm - Dibër |
| 3. Dibër - f. Mogorçë           | 4. f. Mogorçë - Dibër           |
| 5. Dibër –f.Zepishtë            | 6. f.Zepishtë -Dibër            |
| 7. Dibër -f. Banisht            | 8. f. Banisht – Dibër           |
| 9. Dibër –p.k.Bllatë            | 10. p.k.Bllatë –Dibër           |

**Neni 4**

Për transportin të udhëtarëve në linja komunale në teritorin e Komunës Dibër, me furgonë me minimum nëntë karrike (8+1) do të zbatohen dispozitat e Vendimit për transport komunal të udhëtarëve në teritorin e Komunës Dibër nr. 07-453/6.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Kumtës zyrtare të Komunës Dibër”.

**KËSHILLI I KOMUNËS**

**Kryetari,**

**Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08- 698/4 dt. 29.07.2013**  
**PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR**  
**SJELLJEN E DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR**  
**ZGJËRIM TË KUFIRIT TË PLANIT DHE INKORPORIM TË OBJEKTIT**  
**PA LEJE NË PK NR. 6558 KK DIBËR-3**

**59.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET vendimi për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për zgjërime të kufirit të planit dhe inkorporim të objektit pa leje në p.k. nr. 6558 KK Dibër-3 ,miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e pestë dt.25.07.2013.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**



**V E N D I M**

**Nr.07-675/6 dt.25.07.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR SJELLJEN E  
DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR ZGJËRIM TË  
KUFIRIT TË PLANIT DHE INKORPORIM TË OBJEKTIT PA LEJE  
NË PK NR. 6558 KK DIBËR-3**

**60.**Në bazë të nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/11, 54/11, 155/12 dhe 72/13), nenit 2 paragrafi 2 nga rregullorja për standarde për përshtatjen e objekteve të ndërtuara pa leje në dokumentacionin urbanistik planor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 56/11 dhe 162/12) si dhe nenit 27 të Statutit të Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr. 14/03),  
Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 5<sup>të</sup> dt. 25.07.2013 vendosi:

**Neni 1**

Përcaktohet nevoja për sjelljen e dokumentacionit urbanistik - planor për zgjerim të kufirit të planit dhe inkorporim të objektit pa leje në PK nr. 9169 KK Dibër-3 objekt Motel me restorant destinim A4- (P+K1) pronë e Luanesha Capa.

Sipas PGjU në fuqi për qytetin Dibër, objekti në PK nr.6558 KK Dibër-3, gjendet në jashta kufirit planor.

**Neni 2**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë, nga dita e shpalljes në „, Kumtesën zyrtare,, të komunës Dibër.

**KËSHILLI I KOMUNËS**

**Kryetari,  
Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08- 698/5 dt. 29.07.2013**  
**PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT PËR MIRATIMIN E RAPORTIT**  
**PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS DIBËR**  
**PËR VITIN 2013-KUARTALI I DYTË**

61.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),  
Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET përfundimi për miratimin e raportin për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2013 –Kuartali i dytë, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e pestë dt.25.07.2013.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**P Ë R F U N D I M**  
**Nr. 07-675/4 dt. 25.07.2013**  
**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË**  
**KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013-KUARTALI I DYTË**

**62.**Në mbështetje të nenit 32 paragrafi 2 i Ligjit për financimin e njësive të vetqeverisjes lokale („Gazeta zyrtare e RM,, nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007 dhe 156/2009),), nenit 36 paragrafi 1 pika 7 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa zyrtare e Komunës,, nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 5<sup>të</sup> datë 25.07.2013 përfundoi:

**Neni 1**

Këshilli i Komunës Dibër miraton raportin për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2013 –Kuartali i dytë.

**Neni 2**

Raporti për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2013 –Kuartali i dytë është pjesë përbërëse e përfundimit.

**Neni 3**

Ky përfundim hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

**KËSHILLI I KOM UNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**





**K O N K L U Z I O N**

**Nr.08- 698/6 dt. 29.07.2013**

**PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT  
PËR VËNIEN E EMRIT ELIOT ENGËL PËR RRUGË DHE PLOTËSIMIN  
E LISTËS SË EMRAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, URAVE DHE  
OBJEKTEVE TJERA TË INFRASTRUKTURËS NË QYTETIN E DIBRËS**

**63.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibrë (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibrë:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET përfundimi për miratimin e propozimit për vënien e emrit ELIOT ENGËL për rrugë dhe plotësimin e Listës së emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës në qytetin e Dibrës, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e pestë dt.25.07.2013.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**P Ë R F U N D I M**  
**Nr.07-675/8 dt. 25.07.2013**  
**PËR MIRATIM TË PROPOZIMIT PËR PËRCAKTIM**  
**TË EMRIT ELIOT ENGËLL PËR RRUGË DHE PLOTËSIMIN E LISTËS**  
**SË EMRAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, URAVE DHE OBJEKTEVE**  
**TJERA TË INFRASTRUKTURËS NË QYTETIN E DIBRËS**

64.Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit për vetqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM”nr.5/02) dhe nenit 59 të Statutit të komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 5<sup>të</sup> dt. 25.07.2013 përfundoi:

1. Miratohet propozimi për përcaktim të emrit ELIOT ENGËLL për rrugë.
2. Propozim emri nga pika 1 e përfundimit të rradhitet me Listën e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës në qytetin e Dibrës të miratuar nga Këshilli i Komunës Dibër, për plotësimin e të njejtës nën numrin rëndor 92, dhe të dërgohet Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për marrjen e pëlqimit.
3. Plotësim lista me emrin e propozuar është pjesë përbërëse e këtij përfundimi.
4. Ky përfundim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës.

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**PLOTËSIM I LISTËS**

**SË EMRAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, URAVE DHE OBJEKTEVE TJERA TË INFRASTRUKTURËS NË QYTETIN E DIBRËS, KONFORM NENIT 5 TË LIGJIT PËR PËRCAKTIMIN E EMRAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, URAVE DHE OBJEKTEVE TJERA TË INFRASTRUKTURËS**

**1.Lista e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës në qytetin e Dibrës plotësohet:**

<b>LISTA NË GJUHËN SHQIPE</b>	
92	<b>ELIOT ENGËL</b>

**Nr.07-675/9  
25.07.2013  
D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS  
Kryetari  
Bashkim Mashkulli d.v.**



**P Ë R M B A T J A**

53	Konkluzion për shpallje të vendimit për sjelljen e Planin për Veprim Lokal për Biodiversitetin për Komunën Dibër PVLB	75
54	Vendim për sjelljen e Planin për Veprim Lokal për Biodiversitetin për Komunën Dibër PVLB	76
55	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e kompensimit për shpenzimet zgjedhore organizatorëve të fushatës zgjedhore në zgjedhjet lokale 2013	77
56	Vendim për përcaktimin e kompensimit për shpenzimet zgjedhore organizatorëve të fushatës zgjedhore në zgjedhjet lokale 2013	78
57	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e relacioneve dhe vendeve të transportit me furgonë me minimum nëntë karike (8+1) në transport të udhëtarëve në linjë komunale në territorin e Komunës Dibër	80
58	Vendim për përcaktimin e relacioneve dhe vendeve të transportit me furgonë me minimum nëntë karike (8+1) në transport të udhëtarëve në linjë komunale në territorin e Komunës Dibër	81
59	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për zgjërim të kufirit të planit dhe inkorporim të objektit pa leje në p.kk. nr. 6558 KK Dibër-3	82
60	Vendim për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për zgjërim të kufirit të planit dhe inkorporim të objektit pa leje në p.kk. nr. 6558 KK Dibër-3	83
61	Konkluzion për shpallje të përfundimit për miratimin e raportin për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2013 –Kuartali i dytë	84
62	Përfundim për miratimin e raportin për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2013 –Kuartali i dytë	85
63	Konkluzion për shpallje të përfundimit për miratim të propozimit për përcaktim të emrit Eliot Engël për rrugë dhe plotësimin e Listës së emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës	86
64	Përfundim për miratimin e propozimit për përcaktim të emrit Eliot Engël për rrugë dhe plotësimin e Listës së emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës	87

**PËRGATITI: SHËRBIMI PRANË KËSHILLIT**

=====